



EDUKIMI MJEDISOR



Maj 2025

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

"Ajo që bën ka ndikim, dhe ti duhet të vendosësh çfarë lloj ndikimi dëshiron të kesh."

Jane Goodall

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 **Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **prill 2024**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **644**

Mësues të përfshirë **30**

Orë mjedisore të realizuara **28**

28 Shkolla të përfshira

22 Specialistë të angazhuar



“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



pelikani kaçurrel

edukim mjedisor

Liqeni i Shkodrës

biodiversitet



10 maj 2025, Dita Kombëtare e Pelikanit Kaçurrel

Në këtë ditë të veçantë, specialistët e AdZM Shkodër së bashku me Well Point dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Salo Halili” organizuan një orë të hapur mjedisore në Shirokë, në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liçeni i Shkodrës”. Përmes materialeve informuese, të siguruara nga PPNEA, u dhanë njohuri mbi vlerat natyrore dhe ekoturistike të Pelikanit Kaçurrel dhe habitatit të tij. Nxënësit u përfshinë në diskutime mbi protokollet e monitorimit dhe zhvilluan censusin e pelikanit në grupe, duke njohur më mirë rëndësinë e mbrojtjes së këtij shpendi të rrallë.

22 maj 2025, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Shkodër organizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mehmet Shpendi” në Breg-Lum, brenda Parkut Natyror “Lugina e Shalës”. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë dhe shumëllojshmërinë e biodiversitetit, ndërsa përmes aktiviteteve kreative nxënësit patën mundësinë të përfshiheshin në mënyrë aktive në trajtimin e kësaj teme jetike për ruajtjen e natyrës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



ditë botërore

parqet kombëtare

pelikani kaçurrel

rëndësia e bletëve



10 maj 2025, Dita Kombëtare e Pelikanit Kaçurrel

Specialistët e AdZM Dibër organizuan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të në shkollën 9-vjeçare “Myslim Shehu”, në kuadër të Ditës Botërore të Pelikanit Kaçurrel. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me këtë shpend të rrallë, habitatin e tij dhe kërcënimet që e rezikojnë. Në përfundim, ata shprehën mendimet e tyre mbi rëndësinë e mbrojtjes së pelikanit dhe krijuan modele të pelikanit me karton, duke ushtruar kështu kreativitetin dhe ndërgjegjësimin për ruajtjen e natyrës.

20 maj 2025, Dita Botërore e Bletës

Në kuadër të Ditës Botërore të Bletës, specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Irfan Hajrullai”. Përmes aktiviteteve krijuese dhe ndërvepruese, nxënësit u njohën me jetën dhe rolin thelbësor të bletës në ekosistem, si dhe me kërcënimet që vijnë nga faktorët njerëzorë. Ky aktivitet kontribuoi në ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së bletës, si një element kyç i ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

24 maj 2025, Dita Europiane e Parqeve

Në kuadër të kësaj dite, ADZM Dibër organizoi një orë mjedisore ndërgjegjëse me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”. Gjatë aktivitetit, fëmijët ndërtuan një pemë simbolike, ku në çdo gjethe letre shkruan mesazhe për mbrojtjen e natyrës dhe parqeve natyrore. Kjo iniciativë solli një atmosferë kreative dhe edukative, duke kthyer klasën në një hapësirë ku zëri i natyrës u shpreh përmes fjalëve të fëmijëve.





10 maj 2025, Dita Kombëtare e Pelikanit Kaçurrel

Pelikani kaçurrel është një shpend i madh ujqor me sqep të veçantë që përdoret për të kapur peshqit, i njohur për ngjyrën e tij të bardhë dhe praninë në habitatet e lagështa si liqenet dhe ligatinat. Së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja”, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore në kuadër të Ditës Kombëtare të Pelikanit Kaçurrel. Fillimisht, u prezantua një material informues për karakteristikat e këtij shpendi, habitatin dhe mënyrat e tij të ushqyerjes. Më pas, nxënësit punuan në mënyrë të pavarur, duke krijuar pelikanin kaçurrel me letra.

24 maj 2025, Dita Europiane e Parqeve

Specialistët e AdZM Lezhë organizuan një orë mjedisore në kuadër të Ditës Europiane të Parqeve me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Ndoc Gjetja”. Gjatë aktivitetit u promovuan dhe u informuan nxënësit për vlerat natyrore dhe kulturore të mbrojtura në parqet kombëtare dhe natyrore. Në vazhdim, nxënësit u ndanë në grupe dhe morën pjesë në një lojë interaktive për parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura. Në përfundim, stafi i AdZM Lezhë shpërndau fletëpalosje dhe broshura me informacione për Parkun Natyror të Munellës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



orë mjedisore
ekosistem

pelikani kaçurrel
ruajtja e biodiversitetit



10 maj 2025, Dita Kombëtare e Pelikanit Kaçurrel

Në kuadër të Ditës Kombëtare të Pelikanit Kaçurrel, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të në shkollën “Mustafa Myrteza Kaçaçi” në Krujë. Nxënësit u njohën me rëndësinë e këtij shpendi të madh dhe habitatet ku jeton në Shqipëri. Më pas ata realizuan dhe ngjyrosën figura të pelikanit, duke përfunduar me ekspozimin e punimeve të tyre si një mesazh për mbrojtjen e pelikanit dhe natyrës.

15 maj 2025, Dita Ndërkombëtare e Ndryshimeve Klimatike

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Ndryshimeve Klimatike, specialistët zhvilluan një aktivitet mësimor me nxënësit e klasës së 7-të në Shkollën 9-vjeçare “Hamallaj”, Durrës. Gjatë aktivitetit, nxënësit krijuan postera mbi ndryshimet klimatike, duke ilustruar faktorët që i shkaktojnë ato dhe ndikimin e ngrohjes globale në tokë, ujë, kafshë dhe njerëz. Nxënësit diskutuan gjithashtu se çfarë mund të bëjmë për të ndihmuar planetin tonë, duke theksuar rëndësinë e mos ndotjes, kursimit të energjisë dhe mbjelljes së pemëve. Aktiviteti shërbeu si një mundësi për të mësuar dhe bashkëpunuar në mënyrë kreative.

22 maj 2025, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Specialistët e AdZM zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të, ku u diskutua rëndësia e biodiversitetit dhe roli i tij në ruajtjen e ekuilibrit natyror. Nxënësit mësuuan se çdo gjallesë ka një rol të rëndësishëm dhe si mund të kontribuojmë në mbrojtjen e natyrës. Pas diskutimit, nxënësit krijuan buqeta me lule dhe kafshë nga materiale të riciklueshme.



14 maj 2025, orë mjedisore në natyrë

Specialistë të ADZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore në natyrë me nxënësit e klasës së 5-të të shkollës 9-vjeçare “Zhabjak” në Kavajë. Gjatë kësaj ore, nxënësit u ndanë në grupe për të eksploruar mjedisin natyror dhe për të mbledhur materiale të ndryshme nga natyra. Me materialet e mbledhura ata krijuan byzylykë, kapele dhe postera të ngjyrosura me motive të pranverës. Qëllimi i aktivitetit ishte njohja dhe vlerësimi i biodiversitetit të pasur që ofron natyra, si dhe nxitja e ndërgjegjësimit për ruajtjen e saj.

22 maj 2025 Dita Botërore e Biodiversitetit

Në kuadër të Ditës Botërore të Biodiversitetit, në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Bahri Nela” në Zall Bastar, specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së shtatë. Aktiviteti u zhvillua në natyrë, ku nxënësit patën mundësinë të njihen me florën dhe faunën e zonës. Ata krijuan korniza artistike me lule të ndryshme dhe morën pjesë në një lojë edukative, ku ndaheshin në grupe për të shpjeguar në mënyrë argëtuese elementë të biodiversitetit. Kjo përvojë mësimore solli njohuri të reja dhe rriti dashurinë e nxënësve për natyrën.

23 maj 2025, Dita Botërore e Breshkave

Në shkollën 9-vjeçare “Tufinë” me nxënësit e klasës së katërt specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore me temë “Dita Botërore e Breshkave”. Gjatë aktivitetit, nxënësit morën pjesë në aktivitete kreative dhe informuese, duke mësuar për rëndësinë ekologjike të breshkave dhe mënyrat për t’i mbrojtur ato. Ata krijuan modele breshkash me plastelinë dhe ndërtuan dy terrariume që simbolizojnë habitatet natyrore të breshkave të tokës dhe ujit. Mesazhi kryesor ishte rëndësia e mbrojtjes dhe kujdesit për këto krijesa të bukura dhe të dashura.

“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



15 maj 2025, Dita Botërore e Ndryshimit të Klimës

Në kuadër të “Ditës Botërore të Ndryshimit të Klimës”, specialistët e AdZM Berat zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së shtatë në shkollën “Thimi Tani”, Berat. Gjatë aktivitetit, nxënësit diskutuan mbi rëndësinë e ndryshimeve klimatike, faktorët që i shkaktjnë dhe pasojat e tyre në mjedis dhe në jetën e përditshme.

22 maj 2025, Dita Botërore e Biodiversitetit


Nxënësit e shkollës “Drita e Dijes” morën pjesë në një orë mjedisor në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit” dhe “Ditës Europiane të Parqeve” të organizuar nga specialistët e AdZM Berat. Gjatë aktivitetit, ata u njohën me biodiversitetin e larmishëm dhe rëndësinë e pasurive natyrore. Së bashku realizuan veprimtarinë “Mini-ekosistemi në një shishe”, që i afrooi më shumë me natyrën dhe i ndihmoi të kuptonin marrëdhëniet brenda ekosistemeve.

ditë botërore
biodiversitet

zona të mbrojtura
ekosistem

"EDUKIMI MJEDISOR", ELBASAN

15 21 22



15 maj 2025, Dita Botërore e Ndryshimit të Klimës

Në kuadër të Ditës Botërore të Ndryshimit të Klimës, në shkollën 9-vjeçare "Daut Gurra", Dragostunjë, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit. Gjatë aktivitetit, ata u njohën me pasojat e ndryshimeve klimatike dhe problemin e ngrohjes globale, një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë. U zhvillua gjithashtu një pyetësor, ku nxënësit shprehën njohuritë e tyre dhe dhanë mendime mbi mënyrat se si mund të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e gazrave serrë.

21 maj 2025, orë mjedisore

Në kopshtin "1 Qershori", Librazhd, specialistët e AdZM Elbasan, realizuan një orë mjedisore me fëmijët, duke ndërtuar një miniatyrë natyrore dhe duke i njohur ata me kafshët dhe habitatin e tyre përmes lojës dhe krijimtarisë. Fëmijët u angazhuan me shumë interes, mësuan mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe u argëtuan duke formuar elementë të botës së pyllit me materiale të thjeshta e kreative. Aktiviteti kontribui në zhvillimin e shprehive krijuese, bashkëpunimit dhe ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit.

22 maj 2025, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit është një ditë që kremtohet çdo vit më 22 maj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e biodiversitetit – variacionin e jetës në tokë, duke përfshirë bimët, kafshët, mikroorganizmat dhe ekosistemet ku ata jetojnë. Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Elbasan me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Shefqet Dosku", Dorëz, zhvilluan një orë mjedisore pranë Monumentit të Natyrës "Shpella e Plakës" Gizavesh. Ata realizuan një studim të habitatit, evidentuan lloje bimore dhe mësuan hapat për përgatitjen e një herbari. Aktiviteti u karakterizua nga interes i lartë i nxënësve dhe bashkëpunim aktiv gjatë gjithë orës.

Parku Kombëtar "Shebenik" ditë botërore krijimtari
ndryshimi klimatik zona të mbrojtura monument natyre

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



7 maj 2025 orë mjedisore

Specialistët e AdZM Fier organizuan një orë mjedisore në Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Lili Stavre”, Topojë, Fier. Gjatë aktivitetit edukativ, nxënësit u njohën me pasuritë natyrore, biodiversitetin dhe rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve të parkut përmes një prezantimi të specialistëve. Ata diskutuan mbi habitatet e ndryshme, speciet e veçanta të kafshëve dhe bimëve të zonës dhe mënyrat se si mund të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit. Aktiviteti u karakterizua nga interes i lartë i nxënësve dhe bashkëpunim aktiv gjatë gjithë vizitës.

10 maj 2025, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Specialistët e AdZM Fier, në bashkëpunim me ekspertët e Shoqatës Ornitologjike të Shqipërisë (AOS), organizuan një orë edukative me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar Çermë-Sektor, Divjakë, në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë dhe Ditës së Pelikanit. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së shpendëve migratorë dhe ruajtjen e habitateve të tyre natyrore, veçanërisht të Pelikanit Kaçurrel. Ata patën mundësinë të vëzhgojnë ishullin e pelikanit në lagunën e Karavastasë gjatë periudhës së riprodhimit, duke mësuar mbi mënyrat e mbrojtjes së këtij shpendi të rrallë dhe ekosistemit ku ai jeton.

edukim mjedisor

pelikani kaçurrel

pasuri natyrore

park kombëtar

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER

7

10

21

27



21 maj 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Fier organizuan një vizitë studimore në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta për studentët e Universitetit të Tiranës, Departamenti i Gjeografisë, dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës, Departamenti i Biologjisë-Kimisë. Gjatë vizitës, studentët u njohën me zonat e mbrojtura të qarkut Fier, mënyrat e menaxhimit dhe monitorimit të tyre, si dhe me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e veçantë që ofron ky park.

27 maj 2025, praktikë mësimore

Specialistët e AdZM Fier organizuan praktikat mësimore në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta për studentët e Universiteti i Tiranës departamenti Biologjisë FSHN në kuadër të lëndëve Botanikë Sistematike dhe Biogjeografi. Gjatë aktivitetit, studentët morën një përvojë praktike të pasur dhe u njohën me biodiversitetin e veçantë të një nga zonat më të rëndësishme natyrore në vend.

edukim mjedisor

pelikani kaçurrel

pasuri natyrore

park kombëtar



10 maj 2025, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës “1 Maj” me temë: Dita Botërore e Shpendëve Shtegëtarë. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me shpendët shtegëtarë që kalojnë në territorin e vendit tonë, duke mësuar për përmasat e tyre, ushqimin dhe zakonet e shtegëtimit. Ata diskutuan mbi rëndësinë e mbrojtjes së këtyre shpendëve dhe të habitateve ku ata jetojnë, si dhe mbi mënyrat se si mund të kontribuojnë në ruajtjen e tyre përmes veprimeve të thjeshta mjedisore. Aktiviteti u karakterizua nga interes i lartë i nxënësve dhe bashkëpunim aktiv gjatë gjithë orës.

20 maj 2025, Dita Botërore e Bletëve

Specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së katërt, duke diskutuar me ta mbi rëndësinë e bletëve. Fëmijët mësuan se bletët janë shumë të rëndësishme për mjedisin dhe jetën njerëzore, sepse polenizojnë bimët, kontribuojnë në prodhimin e frutave dhe perimeve dhe prodhojnë mjaltë. Ata diskutuan mbi mënyrat për t'i mbrojtur bletët dhe habitatet e tyre, kuptuan rolin e tyre në ruajtjen e biodiversitetit dhe shprehën interes për të mbrojtur këto krijesa të çmuara.

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË

15 23



orë mjedisore

zona të mbrojtura

informim

park detar

15 maj 2025, orë mjedisore

Specialistët organizuan një orë mjedisore për metodat e monitorimit të cilësisë së ujërave me kite në Qendrën e Breshkave Detare, Vlorë, me studentët e Degës së Akuakulturës. Gjatë aktivitetit, 10 studentë mësuan për metodën Smart të monitorimit, përdorimin e sondave dhe kite-ve për të matur parametrat e ujit, si dhe mënyrën e interpretimit të të dhënave të marra.

23 maj 2025, orë mjedisore

Studentët e Degës së Kimisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, morën pjesë në një orë mjedisore mbi metodat e monitorimit të cilësisë së ujërave me kite, të organizuar nga specialistët e AdZM Vlorë. Gjatë aktivitetit, ata mësuan për metodën Smart të monitorimit, përdorimin e sondës parametrike dhe mënyrën e interpretimit të parametrave të ujit. Për aktivitetin u përdorën materiale PowerPoint dhe pajisje praktike për monitorimin e ujërave.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



7 maj 2025, rëndësia e zogjve

Zogjtë kanë një rol shumë të rëndësishëm në ekosistemin tonë, pasi ndihmojnë në kontrollin e insekteve, përhapjen e farave dhe ruajtjen e balancës natyrore. Mbrojtja e tyre është thelbësore për shëndetin e mjedisit dhe biodiversitetin. Në këtë kuadër, specialistët e ADZM Korçë organizuan një aktivitet edukativ në shkollën “Abdulla Progri” në Progër, ku nxënësit e klasës së 7-të vendosën fole zogjsh dhe morën njohuri mbi rëndësinë e zogjve dhe nevojën për të ndaluar gjuetinë ndaj tyre. Ky aktivitet synon të rrisë ndërgjegjësimin e të rinjve për ruajtjen e natyrës.

22 maj 2025, orë mjedisore

Në shkollën “Hodo Skënderi” në Strelcë, specialistët e ADZM Korçë, në bashkëpunim me organizatën PPNEA, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasave të 6-ta. Gjatë aktivitetit, nxënësit mësuan për Rrëqebullin Ballkanik përmes prezantimeve dhe posterave informues. Mesazhi kryesor ishte njohja dhe vlerësimi i gjitarëve që jetojnë në zonat e mbrojtura.



@akzm.gov.al



@akzmalbania



@akzmalb

edukim mjedisor

specie të rrezikuara

fauna

biodiversitet

zona të mbrojtura



Së bashku me klasat e 9-ta të shkollës "Muharrem Çollaku" në Pogradec, u zhvillua një orë mjesdore për rëndësinë e planetit Tokë në jetën e gjithësecilit prej nesh. Ndamë këshilla për nxënësit, se si ne duhet të veprojmë për të ruajtur mjedisin. Prezantimi që paraqitëm u shoqërua me diskutime të frytshme mes nesh dhe nxënësve.